



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Nr. 78 prot.

Tiranë, më 28.01. 2020

**NJOFTIM PËR BASHKËPUNTORË TË JASHTËM PËR ZHVILLIMIN E
PROCEDURAVE TË PROVIMIT TË 'KUALIFIKIMIT TË MËSUESVE', 2020**

Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP), kërkon bashkëpunëtorë të jashtëm, për hartues dhe vlerësues të testeve të provimit të 'Kualifikimit të Mësuesve', 2020.

Bashkëpunëtorët duhet të plotësojnë këto kërkesa:

Hartuesit dhe vlerësuesit e testeve duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

1. Të kenë mbaruar arsimin e lartë me kohë të plotë në një nga degët e mësuesisë për lëndën përkatëse.
2. Të kenë një eksperiencë pune jo më pak se pesë vjeçare në mësimdhënie.
3. Të kenë hartuar teste në nivele të ndryshme institucionale dhe/ose të kenë marrë pjesë në vlerësime të testeve të ndryshme.
4. Të kenë rezultate të larta në punën e tyre mësimdhënëse.
5. Të kenë marrë pjesë në aktivitete të ndryshme për zhvillim profesional.
6. Të japin ose të kenë dhënë mësim në njërin nga nivelet e arsimit parauniversitar (ose Universitar).

Hartuesit/ vlerësuesit e testeve nuk lejohet të jenë:

1. Autorë të teksteve mësimore.
2. Autorë të librave ndihmës për nxënësit apo mësuesit, përveç atyre që botohen nga IZha, QSHA, ISHA.
3. Kandidatë ose të kenë të afërm të kandidatëve për marrjen e shkallës së kualifikimit.

Kandidatët për hartues/vlerësues të testeve dorëzojnë CV-në dhe këto dokumente (fotokopje: e diplomës së shkollës së lartë, e librezës së punës, e dokumentit të identitetit) pranë sekretarisë së Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP), brenda datës 31.01.2020, ora 14.00.

Faleminderit!

